



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr. 38 prot.

Kamëz, më 11.3.2022

V E N D I M

Nr. 34 Datë 11.13.2022

MBI

MIRATIMIN E NJË NDRYSHIMI DHE NJË SHTESE NË LISTËN E VENDIMIT NR.116 DATË 19.11.2021 SË SUBJEKTEVE TË CILËT PËRFITOJNË NGA GRANTET PËR RINDËRTIMIN E SHTËPIVE INDIVIDUALE, TË DËMTUARA NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019, VLERËSUAR NGA AKT-EKSPERTIZAT E THELLUARA TË INSTITUTIT TË NDËRTIMIT “ PËR SHEMBJE “

Këshilli Bashkiak Kamëz i mbledhur sot më **11.03.2022** në kushte të veçanta si pasojë e masave të ndërmarra për parandalimin e përhapjes së virusit COVID-19 , pasi mori në shqyrtim **Projekt-Vendim Nr.31 Datë 10.03.2022** në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, aktin nr. 09 datë 16.12.2019, “ Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, Vendimin nr. 750, datë 27.11.2019 “ Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës, Tiranë dhe Lezhë”, të ndryshuar, Vendim Nr. 904, datë 24.12.2019 “ Për përcaktimin e rregullave, të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga disa programe të procesit të rindërtimit”, Vendim Nr.5, datë 06.01.2020 i ndryshuar “ Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model”, Vendim Nr.8, datë 06.01.2020 “ Për përcaktimin e kushteve dhe të kriterëve të përfitimit të sipërfaqeve ndërtimore në objektet e reja për banim nga subjektet që posedojnë ndërtime të klasifikuara si ndërtime pa leje”, Vendim Nr. 887, datë 24.12.2019 “ Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurës së përshpejtuar për hartimin dhe miratimin e planit të detyruar vendor, si dhe procedurës së miratimit të zhvillimit/ndërtimit, në rastet e fatkeqësisë natyrore”,Vendim Nr.22, datë 13.02.2020, të Këshillit Bashkiak Kamëz “ Për miratimin e manualit të procedurave për përfitimin nga programet e rindërtimi “ Urdhërit nr. 632 datë 18.12.2020 “, **Këshilli Bashkiak Kamëz “;**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ**

V E N D O S I:

1. Miratimin e një ndryshimi në listën e subjekteve përfitues të Vendimit Nr.116 Datë 19.11.2021, të cilët nuk plotësojnë plotësojnë kriteret ligjore për të përfituar nga Programi i Rindërtimit.
2. Miratimin e një shtese të subjekteve përfitues, objektet e të cilëve janë të përcaktuara nga akt-ekspertizat e thelluara të Institutit të Ndërtimit me nivel dëmtimi "Për Shembje".
3. Lista e subjekteve që shfuqizohen në pikën 1 (një) të këtij vendimi paraqitet në aneksin bashkë-lidhur dhe është pjesë e këtij vendimi.
4. Lista e subjekteve shtesë të përcaktuar në pikën 2 (dy) të këtij vendimi paraqitet në aneksin bashkëlidhur dhe është pjesë e këtij vendimi.

Lista e subjekteve shtesë përfitues e përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, paraqitet në aneksin bashkë-lidhur dhe është pjesë e këtij vendimi.

5. Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit ligjor nga **Prefekti i Qarkut Tiranë**.

**Kryetar Këshilli
Hysen Koldashi**

